



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-058

Prishtinë, më 8 shkurt 2019, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 SHKURT 2019**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Elmi Reçica, Albulena Haxhiu, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi, Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha dhe

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme,
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

\* \* \*

### **1. Kërkesa e 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 40 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme të Kuvendit, më 8 shkurt 2019, për të debatuar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të premtën, më 8 shkurt 2019, në orën 12:00, me këtë:

### **Rend dite**

*1. Debat parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës*

\* \* \*

### **2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

*1. Kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për lejimin e shpenzimeve të këtij komisioni*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për lejimin e kompensimit të shpenzimeve në shumën prej 3,495.20 euro lidhur me punëtoritë e mbajtura në Prishtinë, në lidhje me amendamentimin e tri (3) projektligjeve, sipas faturave të bashkangjitura.

### *2. Kërkesa e zonjës Eliza Hoxha për mbështetje financiare për realizimin e një projekti*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Znj. Eliza Hoxha mbështetet financiarisht në shumën prej 4,700.00 euro për realizimin e ekspozitës “Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve”, e cila do të organizohet në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### *3. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haxhi Shala, për lejimin e udhëtimit zyrtar*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Kryetarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, i lejohet udhëtimi zyrtar në Çikago (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), prej 27 shkurt deri më 10 mars 2019.

### *4. Kërkesa e Shoqërisë Kulturore Artistike “Mladi Talenti” nga Prizreni për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

OJQ-ja Shoqëria Kulturore Artistike “Mladi Talenti”, me seli në Prizren, mbështetet financiarisht në shumën prej 2,386.00 euro për realizimin e Festivalit të miqësisë dhe shoqërimit.

### *5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti, dhe deputetit z. Ismet Beqiri, u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë) prej 10 - 12 shkurt 2019.

### *6. Kërkesa e studentes Çamërie Mazreku për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Studentja Çamërie Mazreku nga Malisheva mbështetet financiarisht në shumën prej 4,950.00 euro për shkollimin e saj universitar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

### *7. Kërkesa e z. Dibran Qela për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Z. Dibran Qela nga komuna e Mitrovicës mbështetet financiarisht në shumën prej 4,950.00 euro, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit dhe trajtimit shëndetësor të vajzës së tij.

### *8. Kërkesa e nënkryetarit Kujtim Shala për lejimin e udhëtimit zyrtar*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kujtim Shala dhe këshilltarit të tij, z. Ndue Ukaj, u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri prej 14 - 15 shkurt 2019.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për realizimin e vizitës së lartshënuar mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

### *9. Kërkesa e Shoqatës Socio-Edukative "Don Bosko" në Prishtinë për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

OJQ Shoqata Socio-Edukative “Don Bosko” në Prishtinë mbështetet financiarisht në shumën prej 4,950.00 euro për realizimin e projektit për vendosjen e shtatores së Shën Terezës në Panama.

Në fund, kryetari i njoftoi të pranishmit se Kuvendi më 17 shkurt 2019, me fillim në orën 10:45, do të mbajë seancë solemne, me këtë:

### Rend dite

#### *1. Shënimi i 11-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës*

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*